KUVENDI
NR 2616 DATE 14.10.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KUVENDI**

Nr.____Prot. Tiranë më ___________2020

**Lënda:** **Kërkesë për interpelancë me Ministren e Financave znj.Anila Denaj**

**Drejtuar :** **z.Gramoz Ruçi**
**KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Zoti Kryetar i Kuvendit !

Bazuar në nenin 80, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në nenin 96 të Rregullores së Kuvendit, ju paraqes kërkesën për interpelancë me Ministren e Financës, për të diskutuar çështjet e mëposhtme :

Në mbyllje të një sezoni të vështirë turistik, keni një bilanc sa kanë qenë humbjet e këtij sektori ?

Sa biznese janë të mbyllura për shkak të Covid-19 ? Sa është numri i njerëzve që kanë humbur punën ?

Bizneset janë vendosur para tre zgjedhjeve në këto kohë të vështira për to:
- Të mbyllë biznesin, sepse nuk përballon dot shpenzimet konstante të tij
- Të marrë kredi dhe të riskojë duke mbyllur sytë pa bërë asnjë llogari
- Të vazhdojë lëngatën e tij duke bërë shkurtime në fuqi punëtore

Ku e shikon veten Qeveria në raport me keto zgjedhje të detyrueshme të biznesit ? Kush janë aktet e qeverisë që tregojnë përgjegjësinë dhe rolin paternalist të saj ?

Si e koncepton Qeveria nocionin "Tatim" për bizneset ?

Çfarë kuptimi ka për Qeverinë "Tatami i Thjeshtuar" që biznesi duhet ta paguajë paradhënie ? Ku e di Qeveria se sa do të fitojë biznesi në fund të muajit që tatimin e kërkon paradhënie ?

Qeveria ka miratuar një Akt Normativ për shtyrjen e tatim-fitimit. Si mendon Qeveria ? Ku do t'i gjejë paratë biznesi për tatim-fitimin e mbartur gjatë muajve që nuk punoi dhe atë të krijuar gjatë muajve që do të punojë me efiçencë jo të plotë ?

Është koha që Qeveria ta vendosë veten në krah të biznesit apo në mbrojtje të buxhetit të shtetit ?

A mendoni se gjobat e çdo inspektori bashkiak apo tatimor që janë urdhër ekzekutiv, duhen hequr?

Kush është metodologjia e Qeverisë për të dalë nga kriza e thellë e depresionit ekonomik ? A po ndjek ndonjë model të Qeverive të Perëndimit, si shtete që kanë eksperiencë të gjatë në treg ?

Çfarë kupton Qeveria me taksë arsimi ? Përse vazhdon të aplikohet kjo taksë edhe në këtë kohë ?

A i qëndron Qeveria idesë së Aminstisë Fiskale mbas kritikave të ndërkombëtarëve apo u tërhoq?

Sa pëqind do të jetë rritja e pagave të mjekëve në propozimin tuaj në projektbuxhetin e vitit 2021 ? Nga se vjen kjo ? Kuptuat rëndësinë dhe vlerën e punës që ata kryejnë për shëndetin tonë, apo është strategji e Qeverisë për çdo kategori shoqërore ? Si do t'i garantoni këto para që ta besojmë këtë gjë ?

Sa qytetarë janë gjobitur nga Qeveria, sepse kanë kërkuar Qeranë e Objekteve të tyre jashtë Aktit Normativ të Qeverisë, i cili nuk lejonte ata që gjatë kohës së mbylljes të kërkonin qeratë e objekteve të tyre, dhe e shtynte këtë detyrim ?

**Artur Roshi**

**DEPUTET**